



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar””.
2. Të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Musa Ulqini, Arben Kamami, Klodjana Spahiu, Mirela Kumbaro, Ralf Gjoni, Ilir Pendavinji dhe Andrea Marto Sadri Abazi.

Mungojnë:

Fatmir Velaj, dhe Taulant Balla.

Të ftuar:

Ornela Çuçi - Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marikaj – Drejtoreshë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari - Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Integritetit Europian. Sot në rend të ditës kemi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, të cilin do ta shqyrtojmë nën për nen.

Sa i përket projektligjit “Për rininë”, do të vazhdojmë me pjesën e dytë.

Fillojmë me projektligjin e parë. Në komision ndodhet zonja Ornela Çuçi, zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit, e cila do të na bëjë një prezantim sa i takon këtij projektligji.

Ornela Çuçi – Faleminderit!

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian, disa nga detyrat që na janë vënë gjatë procesit të *screening* për ta zbatuar këtë ligj është edhe përafrimi i paketës ligjore që ka të bëjë me natyrën.

Në vitin 2008 është miratuar ligji për mbrojtjen e faunës së egër, ndërkohë që në vitin 2009-2010, ka pasur disa ndryshime në direktivat e Bashkimit Europian për ruajtjen e habitateve natyrore të florës dhe faunës së egër, si dhe për konservimin e shpendëve të egër, të cilat duhet të reflektohen më tej në këtë ligj.

Bazuar në këto ndryshime, që kanë ndodhur gjatë periudhës 2009-2010 në Bashkimin Europian, ne kemi ardhur me propozimin për ta ndryshuar ligjin “Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”, për të cilën ka pasur një dëgjese me publikun në datën 31.10.2018. Gjithashtu, në muajin mars të këtij viti së bashku me Këshillin Konsultativ kemi bërë diskutime me bashkitë, sepse janë disa që prekin bashkitë. Ndryshimet që përcaktohen bazuar në këtë ligj janë diskutuar me shoqatat e mbrojtjes së mjedisit dhe tri nga shoqatat që kanë paraqitur ndryshimet dhe konstatimet e tyre për këtë ligj janë Shoqata e Ruajtjes së Shpendëve dhe Vegjetarëve të Shqipërisë, Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror dhe Shoqata e Ornitologëve. I vetmi ndryshim që nuk është marrë parasysh si propozim i ardhur nga këto shoqata ka qenë ai për ndryshimin e llojit të municionit, nga municion plumbi në municion jotoksik, e prezantuar nga Shoqata e Gjuetarëve të Shqipërisë.

Duke qenë se aktualisht Shqipëria është në vitin e katërt të kuadrit të zbatimit të Moratoriumit për Gjueinë, kjo gjë nuk është marrë parasysh në këtë ligj, por kjo do të kihet parasysh kur të bëjmë ndryshimet në ligjin për gjueinë.

Në nenin 1 të këtij ligji bëhet ndryshimi i titullit të ligjit ekzistues dhe është përfshirë termi “konservim”, për shkak se në këtë mënyrë prezantohej në direktivën e Bashkimit Europian, por nga ana tjetër do të duhet që Shqipëria të punojë akoma më shumë sa i takon çështjes së konservimit të specieve endemike, pasi një pjesë e tyre do të jenë në proces zhdukjeje në vitet e ardhshme dhe do të duhet të merren masa më të mëdha për konservimin e tyre dhe shpendëve të egër.

Për shkak të reformës territoriale iu janë shtuar kompetencat njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, ndër to edhe mbrojtja e faunës së egër.

Ndryshimet e bëra në disa nene të kreut 2 të këtij ligji bazë kanë të bëjnë me forcimin e synimit të kërkesave të mbrojtjes, duke u shtuar në të gjitha këto nene termi “konservim”. Në nenet 8 dhe 9 të këtij kreu janë bërë shtime kompetencash për njësitë e qeverisjes vendore pas reformës territoriale dhe përfshirjen e institucionit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, i cili nuk ka qenë pjesë e parashikuar në vitin 2008, sepse është krijuar në vitin 2015 dhe në këtë kuadër do të duhet të jetë i agreguar brenda këtij ligji. Një pjesë tjetër shumë e rëndësishme e parashikuar në këtë ligj është ngritja e Këshillit Kombëtar të Faunës së Egër, i cili është një këshill këshillimor, që do të kontribuojë në lehtësimin e dispozitave të këtij ligji dhe të disa akteve nënligjore, të cilat do ta pasojnë.

Gjithashtu, ky ndryshim sa i përket Këshillit Kombëtar të Faunës së Egër është paraqitur në nenin 37 të këtij ligji.

Organet, të cilat janë të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, janë Ministria e Turizmit dhe agjencitë nën varësi të saj.

Rudina Hajdari - Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Kasneci, për të parë përafrimin e legjislacionit me Bashkimin Europian.

Dedë Kasneci – Ky projektligj për mbrojtjen e faunës së egër, sikurse u prezantua edhe nga përfaqësues të qeverisë, është përafruar pjesërisht me dy direktiva të Bashkimit Europian, konkretisht me direktivën e vitit 1992, e ashtuquajtura ‘Direktiva e habitateve’, dhe pjesërisht me direktivën e vitit 2009 e quajtur “Direktiva e shpendëve të egra”. Shërbimi ynë e ka analizuar, kemi përgatitur edhe opinionin ligjor për një përfarim më korrekt dhe të saktë me Bashkimin

Europaian. Kemi paraqitur në total 9 amendamente. Dje pas mbledhjes i kemi diskutuar edhe me përfaqësues të qeverisë, duke përjashtuar njërin, nga i cili u tërhoqëm, ndërsa për të tjerët kemi rënë dakord.

Sot diskutuam, por i vetmi problem është se në ligj termi anglisht “conservation” është përdorur në dy variante të ndryshme. Në nenin 3 pika 1, 3, germa “c” dhe pika 3, germa “d” dhe neni 4, pika 1, përdoret termi “konservim”, ndërsa në nenin 3, pika 3, germa “a”, pika 3, germa “ç”, nenin 4, pika 1 dhe 3, në nenin 5, germa “dh”, nenin 6, pika 1 nenin 7, pika 1, përdoret termi “ruajtje”. Në vlerësimin tonë sugjerojmë që të përdoret termi ruajtje.

Kjo është e vetmja mospërputhje që kemi, por kuptohet, zonja kryetare, që atë e vendosni ju.

Specialiste – Të bëjmë një sqarim. Kemi dashur të jemi në përputhje me direktivat e Bashkimit European, sepse shkruhet “conservation” kudo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi propozuar diku termin “conservation” dhe diku termin “ruajtje”.

(Diskutime pa mikrofon)

A mund të mbajmë qetësi, ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari - Zonjë, ka një rregull, pavarësisht se po diskutojmë në këtë formë. Unë duhet t’ia jap fjalën gjithsecilit. Mos flisni në këtë mënyrë, sepse po thyeni çdo rregull!

Sapo foli zoti Kasneci. Unë kam një pyetje: nëse fjalët “konservim” dhe “ruajtje” janë njësoj dhe fjala “ruajtje” është shqip, pse në legjislacionin shqiptar ne duhet të përdorim një fjalë të huaj dhe të mos mbajmë fjalën shqip?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro - Unë jam dakord edhe për arsye profesionale, por në legjislacion, sidomos kur bëhet fjalë për një legjislacion, për një ligj apo për një tekst rregullator, i cili mund të ketë edhe një efekt komunikimi ndërkombëtar, për thjeshtësi komunikimi, shpeshherë ruhet termi i huazuar, i cili tregon përafrimin. Nuk jam në gjendje të them nëse ky tekst është i komunikueshëm apo duhet të jetë i unifikuar edhe me legjislacionet e ngjashme në vendet e tjera, por në çdo rast, edhe nëse përdoret “konservim”, kjo fjalë ka hyrë tashmë në leksikun e gjuhës shqipe dhe bën pjesë në atë që quhet “fondi leksikor i huazuar”. E rëndësishme është që për të njëjtin koncept të

mos thuhet në nenin iks “konservim” dhe në nenin ypsilon “ruajtje”. Të ndahet se cili term do të vihet, vendoset duke pasur parasysh që të jetë i njëjti koncept, qoftë nga pikëpamja e analizës së tekstit, qoftë nga pikëpamja legislative.

Person – Jam dakord me zonjën Kumbaro, por ka një problem: nëse është leksik i huazuar dhe termi në shqip nuk ekziston, unë jam dakord të përdoret fjala e huazuar, por nëse ne e kemi fjalën në shqip, mendoj të zgjedhim fjalën “ruajtje” dhe në këtë mënyrë ruajmë edhe leksikun tonë.

Person – Mendoj se ndryshon koncepti “konservim” nga “ruajtje”. Kanë ndryshim, sepse konservimi është ruajtje e një *status quo*-je në të njëjtën situatë, si puna e censusit, që bllokohet, ndërsa ruajtja është që të ecë dhe të mbrohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person – Fjalën “ruajtje” unë e kuptoj si mbrojtje.

Rudina Hajdari – Atëherë, nëse unë sot jam gjyqtare dhe kam përpara fjalët “konservim” dhe “ruajtje”, ju mendoni se unë duhet ta di diferencën?

Person – Pa dyshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Më vjen keq, por gjyqtarja do të thotë: unë nuk e njoh këtë fjalë, sepse nuk është shqip, dhe do të kemi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dedë Kasneci – Ideja është se nëpërmjet përafrimit mund të përdorim njërën ose tjetrën, por nëse zgjedhim fjalën “konservim” ligji do të ndryshohet sërish, sepse aty ku është përdorur fjala “ruajtje”, duhet të kthehet në “konservim”. Pra, një term ligjor, i përdorur në anglisht “conservation”, në ligj ne duhet ta përdorim me një term të vetëm dhe ky është problemi. Ky term duhet të përdoret në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klodiana Marikaj – Atëherë, bëhet fjalë për konservimin e specieve endemike shqiptare, të cilat janë në zhdukje. Pra, veprohet në mënyrë të atillë që nuk preken kushtet e habitatit. Për shembull, një specie e tillë është kali i qyqes, të cilit i janë gjendur vetëm 4 fole gjithsej deri më sot në malin e Nemërçkës. Kjo specie është në konservim të plotë në territorin shqiptar. Ka specie të tjera, si për shembull, rrëqebulli, që është në konservim të plotë në territorin shqiptar, që nuk preket dhe nuk i ndryshohet habitatit për asnjë lloj arsye. Ka specie të tjera, që nuk janë në këtë nivel zhdukjeje, të cilat kanë nevojë thjesht për ruajtje. Pra, nga ana teknike do të duhet të futemi

pak më thellë në legjislacion dhe të kuptojmë se ruajtja është përdorur për shkak të ruajtjes që do t'i bëjmë edhe habitatit, por jo në mënyrë të pacenueshme. Konservimi ka të bëjë me atë lloj habitatit që rrezikon në mënyrë të pashmangshme humbjen e disa specieve endemike shqiptare, që nuk gjenden në asnjë vend tjetër.

Ne leksikunshqiptar nuk mund të gjenim një fjalë të përshtatshme, që t'i përqaset kaq mirë fjalës “konservim”, sa ç’është vetë fjala “konservim”. Ruajtja ka spektër pak më të gjerë për sa i përket nivelit teknik të ruajtjes së një specie endemike.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ralf Gjoni - Fjala “konservim” ka edhe aspektin e mbrojtjes totale, jo vetëm të ruajtjes.

Unë jam dakord që kjo është një pikë shumë e rëndësishme, që duhet konsideruar. Fjala “ruajtje” nuk e jep tamam kuptimin fjalës “konservim”.

Klodiana Marikaj – A mundem, zonja kryetare?

Rudina Hajdari – Po.

Klodiana Marikaj – Si mund ta shpjegojmë ne këtë gjë në gjuhën shqipe, e cila është shumë e pasur, dhe të përdorim vetëm një fjalë të vetme? Pra, ne nuk po bëjmë diferencime, por po mbrojmë ato që kanë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Klodiana Marikaj – A mundem, zonja kryetare?

Pra, terminologjia në fjalorin e biologjisë nuk është kaq e thjeshtë, siç ju e paraqisni. Kjo nuk është çështje ligjore dhe çështje fjale ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lejoni të mbaroj!

Pra, nuk është thjesht çështje fjale, sepse përfaqsimin e direktivës së BE-së në realitetin shqiptar duhet ta shikojmë nga një këndvështrim tjetër. Ne nuk mund të konservojmë çdo specie, që ndodhet sot për sot në territorin shqiptar, sepse nuk i kemi kushtet për ta bërë këtë gjë, por për disa specie ne rrezikojmë të bëjmë konservim të plotë. Këtë mund ta bëjmë edhe në një zonë të mbrojtur me një sërë instancash të tjera, por ne nuk i kemi mundësitë për të implementuar konservim për çdo lloj specie endemike shqiptare. Realisht, ne nuk i kemi këto kushte dhe nuk do t'i kemi edhe në vitet e ardhshme që ky ligj do të veprojë. Në këtë terren dhe në këto mundësi...

Rudina Hajdari – Për cilat specie po flisni, që disa ne jemi gjendje t'i konservojmë dhe disa të tjera jo?

Klodiana Marikaj – Speciet që janë në zhdukje.

Rudina Hajdari – Ku e keni ju të shkruar këtë gjë, sepse kështu i bie që ti me mendjen tënde do të vendosësh se kë specie do të konservosh dhe kë do të ruash?

Klodiana Marikaj – Jo , nuk është kështu.

Rudina Hajdari – Sepse këtu nuk ka asnjë përputhje.

Klodiana Marikaj – Ne kemi një guidë të saktë, të cilën mund ta paraqesim para këtij komisioni, që tregon se cilat janë speciet që duhen konservuar në Shqipëri, cilat janë në rrezik zhdukjeje dhe cilat mund të zhduken në vitet e ardhshme. Ka një kategorizim të nivelit të specieve në të gjithë territorin shqiptar, është libri i faunës shqiptare, i cili nuk është i vendosur nga ministria jonë, por nga një grup specialistësh të terrenit, nga agjencia jonë e zonave të mbrojtura dhe i gjithë universiteti i shkencave të natyrës në Shqipëri, të cilët kanë punuar për një kohë të gjatë dhe kanë përcaktuar të gjithë guidarin e specieve në territorin shqiptar.

Rudina Hajdari – A mund të na shpjegoni se si është procesi konservimit dhe procesi i ruajtjes në rezervimin e kafshëve?

Klodiana Marikaj – Konservimi ka të bëjë jo vetëm me mosprekjen e species, por edhe të habitatit të tyre, pra vendit ku ata jetojnë, i cili ngelet i pandryshueshëm as me prerje pyjesh, as me kthime të pyllit në tokë kullotë ose nga kullotë në tokë truall, sepse është një specie e konservuar. Habitatit i species së konservuar nuk preket për asnjë arsye.

Habitatet e specieve të ruajtura kanë parametra të tjerë, si ai i ndryshimit të habitatit me prerje të pyjeve për ngrohje dhe për pastrim të habitatit ose në prerje të pyjeve sipas direktivave që i përcakton agjencia e zonave të mbrojtura.

Senida Mesi – Kam një pyetje, në ligjin ekzistues është definicioni i shpjeguar se çfarë do të thotë “ruajtje” në kuptimin e këtij ligji? Në pikën 1/1.1 keni shtuar definicionin “konservim”, i cili është një term i ri. Unë dua të kuptoj nëse në ligjin ekzistues termi “ruajtje” është i shpjeguar në këtë linjë?

Dedë Kasneci – Ligji ekzistues e ka: “Ruajtje e numrit të popullatës”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Të cilës popullatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Popullata ka të bëjë me specien që po flasim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – A ka mundësi që në projektligjin e ri t’i definojmë të dyja fjalët, fjalën “ruajtje”, që do të thotë ruajtje e species dhe jo e habitatit dhe fjalën “konservim” është ruajtja e species dhe e habitatit? Pra, kjo është risia e masave, që ne të jemi të qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dedë Kasneci – Kjo nuk e bën diferencimin.

Rudina Hajdari – Unë jam dakord deri diku, por, po ta shikojmë nga ana logjike, zonja sapo tha se kafshët ndahen në specie që janë duke u zhdukur, në specie që janë zhdukur dhe disa specie që do të zhduken, atëherë përse të mos i ruajmë të gjitha njësoj, apo të presim deri sa të zhduken pastaj t’i konservojmë?

Klodiana Marikaj – Keni të drejtë për këtë. Edhe ne kështu duam ta bëjmë, sepse jemi më mjedisor se të gjithë komuniteti që na rrethon, por nga ana tjetër duhet të specifikojmë që për çdo moszbatim të këtyre ligjeve, të cilat ne e kemi të pamundur t’i implementojmë, sepse këto janë kushtet e Shqipërisë, do të duhet të penalizohemi nga Bashkimi Eurpian. Në këtë mënyrë ne nuk po themi se nuk po i mbrojmë speciet, por po i mbrojmë në kushtet që Shqipëria mund të ofrojë. Për implementimin e ligjit do të duhet të marrim edhe masa të tjera, prandaj në kushtet që ne jemi mund të ofrojmë këtë për disa specie.

Rudina Hajdari – Atëherë nuk po bëjmë përafrim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodiana Marikaj – Jo, ne po bëjmë përafrim.

Rudina Hajdari – Si kryetare e Komisionit të Integritetit, bashkë me nënkryetarin nuk mund të tolerojmë që në ligj të jetë: “Siç janë kushtet në Shqipëri”. Këtë nuk e bëj dot. Unë duhet të bëj përafrimin dhe pastaj ministria të gjejë buxhetet dhe t’i përafrojë, sepse është çështje juaja për gjetjen e buxhetit, nuk është imja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni prioritetet tuaja dhe ne prioritetet tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq, por nuk e toleroj dot këtë, sepse...

(Diskutime pa mikrofon)

Person – Jam i mendimit të përdoret termi “ruajtje”, sepse kur dëgjoj termin “konservim”, më vjen në mendje sikur do t’i bëjmë konserva peshku. “konservim” do të thotë “i bëjmë konserva”.

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Marikaj - Jam shumë dakord. Unë e kundërshtoj këtë fjalë, sepse do të çuditen edhe gjyqtarët që do ta shikojnë. A mundemi ne ta definojmë termin “ruajtje” në një nen dhe të shpjegojmë se çfarë do të thotë në terminologji?

(Diskutime pa mikrofon)

Mirela Kumbaro – Për sa i përket diskutimit të terminologjisë, nuk jemi në fushën e ligjit, por të profesionit përkatës. Ne nuk mund të marrim vendime për të gjitha argumentet tona, qofshin gjuhësore apo hamendësore, për të zëvendësuar një term me një tjetër, ndërkohë që, për të gjithë profesionistët e fushës, të cilët do të jenë zbatuesit e ligjit, mund të ketë një kuptim tjetër. Përveç argumentimit...

Unë nuk e di, kush jeni ju, zonjë?

Klodiana Mariakaj – Unë jam Klodjana Mariakaj, drejtoreshë e Bidoiversitetit.

Mirela Kumbaro - Me lejen e kryetares, a mund t’ia japim fjalën zonjës, sepse e kërkoi pesë herë, që të thotë mendimin e saj, meqenëse është teknike e punës. Mua më shqetëson fakti që ne, me argumente gjuhësore kombëtare, por edhe të komunikimit ligjor, mund të marrim një vendim që nesër mund të sjellë një pasojë tjetër për përkufizimin shumë strikt të fjalës.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord, por nëse është e njëjta gjë...

Ndaj i kemi deputetët, të cilët do të vendosin në fund. Nëse deputetët janë dakord që e duan edhe këtë, do t’ua japim.

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse zonja ka të njëjtin opinion, do të më duket se po shterojmë të njëjtin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Personalisht, dua të dëgjoj opinionin e zonjës.

Rudina Hajdari – Nëse janë dakord anëtarët e tjerë.

Mirela Kumbaro – Edhe nëse nuk janë dakord, unë serish dua ta dëgjoj.

Rudina Hajdari – Urdhëroni, zonjë!

Klodiana Mariakaj - Përpos argumenteve të zonjës Çuçi, zonjës Kumbaro dhe kolegëve të tjerë, dua të shtoj diçka. Ekziston një listë e kuqe që organizata botërore, IUCN-ja, ka për konservimin, ku përcaktohet qartë gjendja e specieve të Florës dhe të Faunës, dhe ka specie shumë të rrezikuara dhe specie në rrezik zhdukjeje. Këtu nuk i referohem vetëm Shqipërisë, por edhe

vendeve të tjera, dhe kjo listë është e dakordësuar në nivel ndërkombëtar. Duke pasur parasysh statusin që përfaqëson secila specie, ato që kanë nevojë për t'u konservuar, do të konservohen. Unë nuk duhet të ndërmarr asnjë veprim, në totalin e veprimeve të mia, për të ndryshuar numrin e specieve, por duhet ta ruaj vit pas viti, sepse shërben si një bankë gjenetike. Ka edhe specie të tjera që u duhet siguruar një status i favorshëm ruajtjeje, për të cilat unë duhet të marr masa mbrojtëse. Ne tani jemi në kuadrin e moratoriumit të gjuetisë, që nuk lejohet gjuetia, por ka specie, për të cilat mund të hapet sezoni i gjuetisë dhe duhet ruajtur. Për shembull, kemi 80 çifte specimesh si të florës, ashtu dhe të faunës dhe, kur fillon sezoni i gjuetisë vendosen disa kuota, pra meqenëse numri i popullatave ka arritur në 120, atëherë që të kemi një riprodhim, të suksesshëm vitin tjetër, do të lejomë që të kryhet vetën 10%, në mënyrë që jo vetëm ta ruajmë, por edhe të shtojmë numri i këtyre popullatave.

Ndërkohë, direktiva tjetër e Komunitetit Europian për habitatet ka nxjerrë zona të veçanta të ruajtjes, që, në shumicën e rasteve nuk hyjnë në zonat e mbrojtura. Ne kemi 18,5 të zonave të mbrojtura, kurse 82,5% u takon bashkive. Pra, njësitë e qeverisjes vendore do të jenë këto institucione të nivelit lokal, të cilat duhet të marrin masat për të siguruar këtë status të ruajtjes si nga ana e habitatit, ashtu edhe nga lloji i specimesh në totalin e saj. Pikërisht këto zona të veçanta të ruajtjes janë me rëndësi për Komunitetin Europian, që nuk është se ndodhen në të gjitha vendet e Komunitetit Europian. Për shembull një specie mund të ndodhet vetëm një Shqipëri, atëherë si do të trashëgohet kjo vlerë e shtuar në brezat e ardhshëm edhe për Komunitetin Europian për të treguar historinë jetësore apo të njerëzimit dhe natyrës?! Nuk është se ne nuk kemi fonde për të siguruar një status konservimi, konserva, po e marr si term në Fjalorin Shqip-Shqip, ekziston. Konserva është një ruajtje afatgjatë e një statuskuoje të caktuar, kurse ruajtja është një masë parandaluese, ose profilaktike.

Mirela Kumbaro – Ndërkohë po shoh një konventë të vitit 2003...

Rudina Hajdari – Zonja Kumbaro, a mund të flasë zoti Kasneci, pastaj do t'jua jap fjalën?

Mirela Kumbaro – Po, patjetër.

Dedë Kasneci - Zonja kryetare, lidhur me referencat tek OKB-ja është fushë krejt tjetër, e drejtë ndërkombëtare e detyrueshme, jemi shumë larg. Ato i shqyrton Komisioni i Ligjeve. Kur BE-ja aderon në një konventë ndërkombëtare, ajo automatikisht kthehet dhe legjislacion i BE-së, por këtu BE-ja ka mbrojtjen më të mirë në botë për mjedisin, për habitatet, për çdo gjë.

Unë kam një pyetje për zonjën. Dje, gjatë diskutimit më ka thënë që propozimi i ministrisë ka qenë ruajtja. Sot ju mund t'ia kërkon si e kanë çuar në Këshillin e Ministrave, konservim apo ruajtje.

Klodiana Marikaj – E kemi çuar me të dyja: edhe konservim edhe ruajtje.

Rudina Hajdari – Zonja Kumbaro, çfarë kishit për të thënë?

Mirela Kumbaro – Një parim tjetër është dhe mekanizmi i analogjisë, për të parë si është përdorur në tekstet e tjera ligjore të përkthyer në shqip. Megjithatë, sërisht, termi konservim në legjislacionin pararendës shqip, trajton të njëjtën fushë, për të ruajtur të njëjtën logjikë, pavarësisht komisionit tonë, se këtë do ta shohë Komisioni i Ligjeve. Ne po diskutojmë më shumë një aspekt që u takon ligjeve, por m'u duk shterues argumentimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Zoti Kasneci, nuk jua dhashë fjalën.

Unë e dëgjova zonjën Marikaj, por nuk e kuptoj se si ne do të konservojmë një kafshë...

Person f - Habitatin, jo kafshën.

Rudina Hajdari - Habitatin e kësaj speciejë, për ato që janë në zhdukje dhe ato që do të zhduken. Pra, të ulim standardin tonë për një kategori tjetër, ndërkohë që dhe ato do të rrezikohen dhe do të shkojmë prapë te ngritja e standardit. Kjo nuk ka sens logjik.

Ne duhet të kemi një term në unison. Nëse në legjislacionin e BE-së gjeni që ka ndryshim midis kafshëve, pra në mënyrën si ruhen, rezervohen, konservohen... Nëse në legjislacionin e BE-së është vetëm një term për të gjitha këto kafshë, atëherë unë dua të jetë njësoj edhe në legjislacionin shqiptar, meqenëse flasim për përafrim.

Ky ishte komenti im.

Person f – Me sa kuptova, kemi dy nivele të mbrojtjes. Pra, kemi një nivel...

Rudina Hajdari – Në legjislacionin e BE-së kemi dy nivele mbrojtjeje apo një?

Person f – Tre ose katër.

Unë nuk e di, se nuk jam e fushës, por...

Rudina Hajdari – Prandaj kemi zotin Kasneci këtu, që të bëjmë një legjislacion, që, nëse e përafrojmë me BE-në... Zonja tha se merr gjoba nëse nuk e bëjmë në mënyrën e duhur, apo jo?

Nëse duhet të jetë vetëm një term, ne duhet të përdorim termin që është më i saktë.

(Diskutime pa mikrofon)

Klodiana Spahiu – A mundem, zonja kryetare?

Unë kam përpara dhe ligjin e vitit 2008... (*nuk dëgjohet*). Te përkufizimet është e përkufizuar shumë qartë se çfarë është ruajtja e numrit të popullatës. Te neni 4 është e përkufizuar qartë çfarë është fjala “konservim” dhe me logjikën që po ndjekim nuk mund të jenë të barabarta me njëra-tjetrën.

Person f – Ja, ku është në frëngjisht kuptimi i termit “konservim” dhe...

(*Ndërhyrje pa mikrofon*)

Rudina Hajdari – U qartësova për këtë gjë. Zonja Kumbaro tha se kjo fjalë ekziston në Fjalorin e Gjuhës Shqipe.

Mirela Kumbaro – Po, i 2006-s.

Rudina Hajdari – Nëse kushdo që do ta marrë në shqyrtim këtë ligj, do të bazohet te Fjalori i Gjuhës Shqipe, do të shikojë së çfarë është ndryshimi...

Shqetësimi im dhe i kolegëve është të kemi një standard, një legjislacion që i përafrohet legjislacionit të BE-së në mënyrën më të mirë të mundshme. Të mos e ndryshojmë terminologjinë, pra të përdorim “konservimin” në fillim dhe pastaj të përdorim termin “ruajtje”, për të thënë që ne po e bëjmë përafrimin, por ndërkohë kemi 2 standarde.

(*Diskutime pa mikrofon*)

Person f – Edhe vetë direktiva ka disa terma për këtë. Ka *conservation*, *preservation*, ka disa terma....

Dedë Kasneci – Direktiva, zonjë, ka vetëm *conservation*.

(*Diskutime pa mikrofon*)

Rudina Hajdari – Unë nuk kam dëshirë që ky të kthehet në një debat. Përderisa zotëria këtu është drejtor për këtë çështje, ai e di se për çfarë po flet.

Person f – Ne të tjetër nuk e dimë?!

Rudina Hajdari – Ai është vetëm për atë fushë. Ju jeni për një fushë tjetër. Unë e kam për detyrë të kontrolloj ekzekutivin. Zonjë, ju jeni pjesë e ekzekutivit dhe anëtarëve të tjerë të komisionit kemi për detyrë t’u bëjmë këto pyetje.

Person f - Nuk e diskutoj, por jeni duke vënë në diskutim...

Rudina Hajdari – Zotëria është ekspert, ai nuk bën politikë këtu, nuk bën asgjë...

Person f – As ne nuk po bëjmë politikë, por jemi duke folur për një ligj 100% ekspertizë mjedisore. Unë do të doja të përcaktonim...

Rudina Hajdari – Unë kam për të detyrë të bëj këto pyetje dhe zotëria ka për detyrë të më sqarojë.

Person f – Unë nuk thashë pse më bëtë pyetje.

Rudina Hajdari -...sepse unë nuk e di nëse në legjislacionin e BE-së...

Ju po e ktheni në një konflikt, ndërkohë që unë kam dëshirë të di vetëm se si është në legjislacionin e BE-së, që ne të jemi në gjendje ta përfarojmë me legjislacionin e BE-së ashtu siç duhet. Nëse ju më sillni një projektligj që ka dy terminologji të ndryshme dhe nuk specifikoni pse duhet ta kemi në këtë lloj mënyre. Legjislacioni i BE-së e ka ndryshe. Konservon të gjitha kafshët e faunës së egër dhe nuk thotë që disa do t'i konservojmë dhe disa do t'i ruajmë. Pse ne duhet të kemi këtë standard të dyfishtë?

Senida Mesi – U bëmë ekspertë edhe te direktiva e BE-së, por duke lexuar paralelisht ligjin e vjetër, projektligjin e ri, si dhe direktivat e BE-së, dua të them se ligji ekzistues ka vetëm definicionin e “ruajtjes”, ndërkohë ka të përmendur edhe “ruajtjen”, edhe “konservimin”, por nuk e ka të përcaktuar se çfarë do të thotë “konservim”. Këshilli i Ministrave, në rastin konkret ministria përkatëse thotë: “Të shtohet në ligjin ekzistues edhe fjala “konservim” për të sqaruar te ligji ekzistues ndryshimin. Në të gjitha nenet që kam lexuar nuk përmendet më tutje përveçse definicionit të neni 4, pika 1/1. Të gjitha propozimet e tjera janë ndryshime që nuk janë relevante me fjalën “konservim”. Pra, më lë të kuptoj që definicioni i shtuar në rastin konkret te projektligji është thjesht për të sqaruar ligjin ekzistues. Po lexoj direktivën. Është e vërtetë që direktiva ka fjalën, jo ligj për mbrojtjen e faunës, po ta përkthejmë fjalë për fjalë është: “*On conservation of wild birds*”. I bie që ne të përkthejmë dhe ligjin: jo mbrojtje, por në konservim.

Po ta lexojmë, në pikën 7 të direktivës thuhet: “Conservation....”, e të tjera. Në pikën 8 thuhet: “*The preservation, maintenance or restoration of a sufficient diversity and area of habitats is essential to the conservation of all species of birds. Certain species of birds should be the subject of special conservation measures...*”.

Në pikën 9 thuhet: “*In order to prevent...*”. Pra, ka “ruajtje”, ka “mirëmbajtje”, ka “konservim”, ka “parandalim” dhe e sqaron direktiva që disa specie kanë nevojë për konservim, disa të tjera...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duket se po bëhemi semantikë. Unë e kam shumë të qartë tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji ekzistues nuk e ka të sqaruar konservimin. Unë dua ta sqaroj, dua ta përafroj dhe e kam përfshirë në amendimin e ri të ligjit edhe fjalën “konservim” dhe çdo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga ruajtje, dua ta fus në një inkubator dhe dua ta konservoj në gjendjen që është. Kam shkuar një nivel më lartë sesa ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilirian Pendavinji – Zonja kryetare, unë dua të bëj një pyetje për specialistët, pasi ky komision duhet të merret vetëm me përafrimin ligjor dhe nuk duhet të merremi dhe të diskutojmë për terminologjitë teknike. Sa i përafrohemi legjislacionit europian me ndryshimet që i bëjmë këtij ligji? Nëse na duhet përsëri, për shembull në tetor, kur hapen negociatat, atëherë do të na duhet ta shikojmë përsëri këtë ligj vetëm për përafrimin. Nëse do të jetë kështu, është gabim. Ne duhet të jemi të saktë dhe eksplicitë edhe në shpjegime, edhe në atë çfarë...

(Nuk dëgjohet)

Vetëm kështu do ta diskutojmë, normalisht...

(Nuk dëgjohet)

Ilirian Pendavinji – Këtu duhet të jemi në përafrim ligjor. Besoj se kjo do të jetë përgjigja, që do të na vijë nga ju, drejtor.

Dedë Kasneci – Po, patjetër!

(Nuk dëgjohet)

Ç’më duhet mua se ç’bën Veprimtaria prodhuese, që e ka...

Dedë Kasneci – Zoti Pendavinji, Shqipëria ka detyrimin... për të përafruar...

(Nuk dëgjohet)

I gjithë korpusi ligjor është i përafruar plotësisht me legjislacionin e Bashkimit Europian.

(Nuk dëgjohet)

Kjo është në tërësi. Tani zbresim tek elementët e tij specifikë. Në vlerësimin tonë, në lidhje me fjalën “konservim”, duhet të zgjidhet si një term, që të përdoret në mënyrë uniforme. Ju thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Mbaruat?

Dedë Kasneci – Po, kaq kisha.

Rudina Hajdari – Zoti Gjoni, keni ndonjë koment për të bërë?

Ralf Gjoni – Doja të tymoja këtë: ne po merremi me këtë komision, me një definicion teknik, në aspektin gjuhësor. Me këtë duhet të merren ekspertët. Ka problematika për sa i përket fjalës “ruajtje”. Është e vërtetë se fjala “ruajtje” që është shqip, nuk i përmbledh të gjitha veçoritë e fjalës *conservation* në anglisht. Mendoj se po harxhojmë kohë, duke u marrë me një gjë, e cila nuk na takon neve si deputetë, sepse nuk jemi ekspertë aq të paparë ligjorë. Realisht, unë shoh një problematikë këtu.

Rudina Hajdari – Problemi është këtu: na takon neve, si Komision i Integritetit, sepse duhet të kemi një projektligj, i cili të përafrohet sa më shumë me legjislacionin e BE-së. Nëse ne nuk e bëjmë në atë lloj mënyre, nëse ky projektligj miratohet kështu siç është dhe ne nuk e bëjmë punën ashtu siç duhet, atëherë i bie që s’po bëjmë punën tonë.

Ralf Gjoni – Jam shumë dakord me ju, njëqind për qind dakord.

Rudina Hajdari – Prandaj vjen këtu zonja zëvendësministre. Ajo prezanton projektligjin, ndërsa ne kemi detyrë që, me ekspertët tanë, të bëjmë ç’është e mundur.

Ralf Gjoni – Jam totalisht dakord!

Rudina Hajdari – Kështu, nëse zoti Kasneci shpreh shqetësimet e veta, me ekspertizën e tij, që ky projektligj nuk është i përafërt me legjislacionin e BE-së, atëherë ne, si anëtarë të Komisionit të Integritetit, duhet ta marrim shumë seriozisht.

Ralf Gjoni – Një pyetje për zotin Kasneci, nëse mundem! Mundem?

Rudina Hajdari – Po.

Ralf Gjoni – Zoti Kasneci, a i përmbledh fjala “ruajtje” të gjitha karakteristikat e fjalës “konservim”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Musa Ulqini – E jep logjika normale se cili është koncept më i gjerë. Kjo nuk ka nevojë për formim juridik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kishit diçka?

Musa Ulqini – Po, kam diçka.

Rudina Hajdari – Meqë s’ke folur.

Musa Ulqini – Unë mendoj se qeveria e ka sjellë projektligjin... sepse ka një gjë, të cilën e dimë edhe ne: nuk e kemi në unison. Pra, të dyja palët duhet të bëjmë diçka, që ta përafrojmë legjislacionin. Nuk mendoj se qeveria do që ta largojë, ndërsa ne ta afrojmë. Kjo nuk diskutohet,

njëherë. Pra, unë nuk mendoj se kontrolli parlamentar dhe detyra që kemi për ta parë me këndvështrimin tonë specifik, si komision, bie ndesh me faktin se përse qeveria e ka ndërmarrë këtë nismë. Qeveria e ka ndërmarrë këtë nismë, sepse do që ne ta përafrojmë. Kjo është gjë shumë e rëndësishme. Nuk e kuptoj, por duket sikur jemi dy palë, që po konfliktohen në lidhje me disa gjëra, dhe nuk ka arsye. Për këtë çështje, ne jemi në sinkron. Edhe unë në fillim si ju mendova, zonja kryetare, që duhet unifikuar. Në fillim mendova që duhet të jetë shqip dhe m'u duk shumë i drejtë mendimi juaj. Edhe në fjalorin e gjuhës shqipe kjo është. Më pas u bënë disa shpjegime që duhet të jetë një fjalë, pastaj thatë që nuk janë e njëjta gjë dhe më pas logjika që të jetë e unifikuar.

Pasi u dhanë të gjitha shpjegimet, u tha që ka disa nivele. Edhe në legjislacionin europian, me të cilin ne duam ta përafrojmë, ka disa nivele. Në qoftë se kemi tri copë, ne duhet ta konservojmë, por nëse kemi treqind, ne duhet t'i ruajmë. Tre dhe treqind nuk janë e njëjta gjë. Shkallët janë të ndryshme. Vetë legjislacioni europian ka disa shkallë. Këtu më duket sikur është shumë e qartë dhe nuk është fjalë e huaj.

E para, nuk mund të jetë e njëjta, sepse shkallët janë të ndryshme. Qeveria nuk ka qëllim tjetër për këtë pikë. Nuk jemi dy palë me qëndrime të ndryshme. Jemi në sinkron, por duket sikur jemi dy palë gati armiqësore. Jo, jemi në sinkron në këtë pikë.

Këtë diskutim e ndihmuan specialistët, sepse pas shpjegimeve që u dhanë këtu nga një specialiste shumë e mirë unë jam shumë i qartë. Koncepti më i madh përfshin edhe konceptet e tjera. Koncepti "a" përfshin konceptet "b" dhe "c". A është kjo që e përfshin edhe konservimin? Ky është një diskutim logjik, por nuk jemi në atë fushë. Ka disa nivele ruajtjeje në legjislacionin europian. Shpjegimi që dha zëvendësministri dhe specialisti ishte shumë i saktë. Nuk jemi palë të ndryshme dhe është logjike kjo gjë. Këtu nuk ka palë që do të na largojë nga legjislacioni europian dhe ne që duam të afrohem. Puna jonë është ta kontrollojmë ekzekutivin nëse po e bën apo jo mirë punën. Në këtë rast unë mendoj që ky është një diskutim teknik (ne u sqaruam pas dhënies së argumenteve) dhe nuk ka gjë politike që mund të na ndajë. Të gjitha partitë politike, pavarësisht debatit, kur vjen puna te integrimi, edhe ata që bëjnë gjëra kundër integritit, sipas meje, thonë që janë pro integritit. Pra, për integrimin jemi të gjithë dakord. Pas shpjegimet që u dhanë, unë votoj me logjikën që ka disa elemente dhe ne duhet t'i respektojmë dhe nuk largohemi. Ne kemi bërë një hap që nuk e çmoj dot, por jemi dakord me atë gjë.

Rudina Hajdari – Jam dakord me ju. E vetmja gjë që po mundohemi të diskutojmë me njëri-tjetrin *(nuk dëgjohet)* Ne e kemi për detyrë ... *(nuk dëgjohet)*. **Është realiteti shqiptar ky dhe e dimë shumë mirë që ndonjëherë** legjislacioni që bëjmë ka ndonjë kleçkë. Pse të lejohet kjo kleçka kur të jem unë kryetare e Komisionit për Integrimin European dhe të mos e kap?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Musa Ulqini – Respekt maksimal për atë që thoni ju.

Rudina Hajdari – Kështu që unë po mundohem të jem sa më gjithëpërfshirëse për gjithsecilin, që të shprehë opinionin e tij, por nuk është se unë nuk po i marr parasysh...

Musa Ulqini – Nuk është ky rasti.

Rudina Hajdari – Unë i marr parasysh opinionet e tyre.

Musa Ulqini – Nuk është ky rasti, zonja kryetare!

Rudina Hajdari – Nuk është çështja nëse është rasti. Unë kam vetëm një standard për të gjitha ligjet që më vijnë këtu...

Musa Ulqini – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I mirëpres.

Rudina Hajdari – ...për sa i takon përafrimit me legjislacionin e BE-së.

Musa Ulqini – Unë votoj në parim për atë që thoni ju.

Rudina Hajdari – Një standard.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po them.

Nuk kam asgjë unë me zonjat, madje po i dëgjoj dhe jam dakord me argumentet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Absolutisht jo! Unë dua vetëm të jem e bindur, besoj edhe ju duhet ta merrni këtë pozicion, pra të jeni të bindur që të mos ketë asnjëlloj kleçke, që ne nuk e kemi parë, ose një gjë që të na shpëtojë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e vetmja gjë që kam.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Me sa e kuptoj unë zotin Ulqini, i cili foli me një gjuhë paqësore, që nuk e kemi të nevojshme këtu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, ju mbështes totalisht!

Me sa kuptoj, ju doni të thoni që mund të përdoren të dyja termat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thjesht doja ta kuptoja ndërhyrjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Më lini ta specifikoj me një shembull, sepse është shumë teknike. Po ju tregoj një specie. Është kali i qyqes, shqiponja me sqepin e verdhë.

Ralf Gjoni – Që, në mos gabo, gjendet në Vlorë.

Grua – Jo, në malet e Nemërçkës.

Aktualisht, pas studimeve të fundit të biologëve (të cilët dalin përsëri për ekspeditë pas një viti), bëhet fjalë për para dy vjetësh që kanë bërë ekspeditë, kanë gjetur vetëm pesë fole.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është specie totalisht në zhdukje. Për këtë zonat e mbrojtura kanë marrë disa masa të tjera veç ruajtjes së kësaj speciejë: të mos qëllohet, të mos vritet, të çohet ushqim afër species, në mënyrë që ajo të mos zhduket e të tjera. Pra, kanë marrë disa masa më shumë sesa mund të merrnin për ruajtjen.

Kemi specie të tjera, si, për shembull, rosa kërre, e cila gjendet në lagunat tona. Është absolutisht e ndaluar gjuajtja e kësaj rose.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arsyeja është ruajtja, por ne nuk i çojmë ushqim aktualisht rosës. E kemi lënë në vlerësim të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Të ruajë habitatin dhe është e ruajtur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Grua – Nga katër-pesë specie, që gjejmë për shqiponjën, e cila është specie 100% në zhdukje, rosa kërre është specie që ndodhet aktualisht nëpër lagunat tona...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë mënyrë ne kemi nevojë thjesht ta ruajmë, por nuk mund të marrim më tepër masa për ta konservuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Besoj se anëtarët e këtij komisioni e kanë shumë të qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ne shkojmë në të njëjtën linjë me zotin Kasneci dhe kolegun Ilir në lidhje me funksionin e Komisionit tonë: a e kemi të përafruar aq sa duhet? Personalisht jam krejt e qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga ana teknike, a jemi të përafruar ne? A po e luajmë rolin tonë si Komision i Integritetit? A e kemi të përafruar aq sa duhet? A mund ta bëjmë më shumë? Ju thoni që jo.

Grua – Jo.

Senida Mesi – Zoti Kasneci, nga ana teknike, e pranoni që, po, ne e kemi të përafruar këtë legjislacion me këto dy terminologji?

Dedë Kasneci – Për mua jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Senida Mesi – Në rregull.

Dedë Kasneci – Për mua, nuk është e përafruar.

Senida Mesi – Nga ana teknike është shumë e qartë, por e kam shumë të qartë edhe atë se çfarë thotë zëvendësministria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dedë Kasneci – E para, këtë e vendosin deputetët.

E dyta, unë kam për detyrë të ofroj ekspertizën me shërbimin tim, aq sa mundem. Këtë punë, pavarësisht sa vite, e bëj prej 12 vjetësh (kam pasur fatin të jem këshilltar i parë, drejtor i parë)...

Për mua nuk e bën, sepse direktiva përdor termin “konservim”. Ideja ime është që kur do të përdorni termin “konservim”, ta hiqni fare fjalën “ruajtje” nga ligji dhe të bëni mbrojtjen më të mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është ideja jonë. Nëse bini dakord kështu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hiqeni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni që ta shpjegoj. Po ju jap rastin të rosës kërre: si mund ta konservoj rosën kërre, kur është specie migratore? Edhe po të dua, nuk e konservoj dot.

Pelikani kaçurrel është specie migratore, që e përdor territorin tonë jo si habitat vjetor, por e përdor territorin tonë si habitat 6-mujor. Unë nuk e konservoj dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kali i qyqes është 100% i përdorur në habitatet tona. Nuk migron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Po i futemi shumë thellë kësaj çështjeje.

Senida Mesi – Zonja kryetare, unë them ta votojmë dhe ta mbyllim

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kam vetëm një pyetje dhe do ta mbyllim. Është shqetësues fakti që ai thotë se nuk është ashtu. Për mua si deputete, është shqetësuese që eksperti mua më thotë që nuk është. Kështu që edhe kjo është detyra jonë, sepse këtë duhet të bëjmë.

Jam dakord me argumentin që sapo thatë. Këto specie migratore ikin dhe nuk i konservoni dot. Me sa di unë, dhe nuk jam eksperte në këtë fushë, edhe ambienti ku ato do të rikthehen duhet të ruhet, sepse, po ta ndotësh atë ambient, nuk migrojnë më. Prandaj ato ikin dhe nuk kthehen më. Në mënyrë që të kthehen, ne duhet ta ruajmë ambientin, pra habitatin që ata të kthehen. Unë kështu e di. Në qoftë se t'i e ndot ambientin, ata nuk kthehen më.

Specialiste – Direktivat, që janë përqasur me këtë ligj, janë dy: për habitatet e florës dhe të faunës së egër, është e përqasur 100%, pra është *mot a mot* si direktiva e Bashkimit Europia, kurse për konservimin e shpendëve të egër është e përqasur pjesërisht, sepse ne jemi në kushtet e moratoriumit dhe sot për sot nuk mund ta përshtatim 100%. Arsyeja është se nuk lejojmë asnjë specie sot në territorin shqiptar të gjuhet. Direktiva thotë se janë 1, 2, 3 specie që nuk gjuhen dhe 3, 4, 5 që gjuhen. Ne nuk mund ta bëjmë këtë, sepse jemi në kushtet e moratoriumit, i cili prevalon çdolloj direktive sot për sot në Bashkimin European. Moratoriumin nuk do të gjeni në asnjë nga vendet e Bashkimit European dhe në asnjë nga vendet e botës.

Realisht, moratoriumi ka 3 vjet që funksionon në shtetin shqiptar, ka katërfishuar numrin e shpezëve në shtetin shqiptar dhe ka dyfishuar numrin e specieve. Shqipëria, nga vendi i shqiponjave, është kthyer në vendin e flamengove për shkak të këtij moratoriumi. Në këto kushte, respektimi i moratoriumit ka çuar në mosrespektim të direktivës së Bashkimit European në një 100%, por direktiva e habitateve është 100% e transpozuar. Pra ruajtja e habitateve është 100%.

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Zonja kryetare, ti e di më mirë anglishten, sepse ke jetuar aty...

Rudina Hajdari – Nuk është çështja se kam jetuar...

Senida Mesi – Domethënë fjalori anglisht-anglisht për fjalën “*conservation*” ka këtë kuptim: “*The protection of natural things*”, që në shqip do të thotë “konservim, ruajtja e...” Tani jemi duke bërë semantikë këtu...

Rudina Hajdari – Unë po them se të dyja zonjat më dhanë argumentin se disa kafshë migrojnë, pra zonja tha thjesht nuk duhet t’i vrasësh, por unë them se edhe në rastin e këtyre kafshëve migratore duhet ta ruajmë habitatin.

Specialiste – Habitatin e kemi 100% të transpozuar. Te ruajtja e habitatit është 100 % e gjithë direktiva, *mot a mot* siç ishte.

Rudina Hajdari – Prandaj zotëria thotë se duhet të jetë unison.

Ralf Gjoni – Me aq sa kuptoj, kur flasim për ruajtje, zonja zëvendësministre, ne flasim për ruajtjen e habitatit dhe, kur flasim për konservim, flasim për një mbrojtje totale të species. Atëherë, pse të mos qëndrojmë te kjo logjikë? Argumentet mua më janë dhënë të plota dhe shteruese dhe nuk arrij dot të argumentoj...

Senida Mesi – Unë nuk mund të arrij të argumentoj ndryshe.

Ralf Gjoni – Në fillim isha në një mendje me zotin Ulqini, por tani u binda me argumentet, pra po flasim për dy gjëra të ndryshme.

Dedë Kasneci - Një nga problemet që konstatoj këtu, është se i njëjti term i legjislacionit të Bashkimit European është përafruar në legjislacionin shqiptar me terma të ndryshëm. Kjo ka krijuar një problem të jashtëzakonshëm në praktikën gjyqësore. Tek e Drejta e Konkurrencës ka një term *de minimis*, do të thotë që firmat që kanë më pak se 5 % të tregut konsiderohen të parëndësishme. **(nuk kuptohet)** pra, problemi ynë në legjislacionin tonë është një term i përafaruar me terma të ndryshëm, e cila krijon probleme, mosmarrëveshje gjyqësore e të tjerë.

Senida Mesi – Ne jemi dakord, por në rastin konkret...

Dedë Kasneci – Është e njëjta situatë...

Senida Mesi- Jo, nuk është e njëjta situatë dhe analogjia e problemeve që ekzistojnë nuk mund të jetë argument i pazëvendësueshëm që të **(nuk kuptohet)** të gjitha dallimet, sepse është një situatë shumë teknike.

Person- Konservimi i species dhe ruajtja e habitatit janë dy koncepte të ndryshme.

Person- Ajo që tha zonja Hajdari me shumë të drejtë është që...

Person – Edhe në ligj janë dy terma të përcaktuar ndryshe, konservimi është masat që merren për të mbrojtur këtë specie, ruajtja është proces i programuar që synon... Edhe termat janë të ndryshëm dhe të shpjeguara shumë mirë edhe te ligji pararendës, edhe te ky që po amendojmë tani.

Rudina Hajdari- Zoti Gjoni.

Ralf Gjoni –Ajo që ju ngritët me shumë të drejtë, në momentin që specia migron ne duhet të ruajmë habitatin. Ky është argument për të ruajtur të dyja terminologjitë. Ne ruajmë habitatin dhe konservojmë specien. Unë jam dakord me këtë.

Senida Mesi- A mund të kalojmë për votim, ju lutem! Besoj se të gjitha argumentet u ezauruan.

Rudina Hajdari- Atëherë, e kalojmë për votim.

Kush është dakord në parim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4?

Miratohet.

Senida Mesi – Me ato që kemi rënë dakord me ndryshimet e propozuara nga Departamenti i Përafrimit të Legjislacionit ta bëjmë amendimin dhe, nëse e aprovojmë ose jo...

Dedë Kasneci - (nuk kuptohet). Në nenin 4 kemi rënë dakord që fjala “Zonë” të bëhet “hapësirë”.

Rudina Hajdari – A jeni dakord me amendimin?

Miratohet.

Dedë Kasneci – Në nenin 4, pika 2, kemi rënë dakord të vihet “habitat natyror”, sepse është sipas direktivës.

Në nenin 4, pika 5, emërtimi zyrtar është Komisioni Europian.

Rudina Hajdari – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

(Diskutime pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kalojmë në votim.

(Diskutime pa mikrofon)

Kolegë, kalojmë te projektligji për rininë, meqë nuk kishim mundësi, sepse ishte një mbledhje dje. Nuk e di nëse ju ishit, zoti Ulqini.

(Diskutime pa mikrofon)

Është projektligji për rininë. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, por duke qenë se unë kryetare kam propozime për amendime, dua t'i ndaj me ju. Patjetër, nuk është në kompetencën tuaj për të thënë po ose jo. Jeni të lirë të thoni po ose jo. Kjo është komplet në dorën tuaj. Ne nuk jemi komision përgjegjës, por si kryetare e Komisionin të Integritit, unë kam amendimet e mia dhe kam dëshirë t'i propozoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person f – ...E vetmja arsye pse ne kaluam projektligjin për rininë në komisionin tonë ishte për të marrë komentet edhe nga Drejtoria e Përfarimit të Legjislacionit me Bashkimin Europian, nëse duhet apo nuk duhet të kemi një përafrim dhe nëse ligji merr parasysh ndonjë konventë apo direktivë të Këshillit të Europës. Nuk kishim detyrim të tillë. Si rezultat, ne e kaluam dje në parim, sepse kaq është funksioni i këtij komisioni.

Meqë kryetarja ka punuar me disa amendime, për respekt të saj, po e dëgjojmë, por propozimi im është, si Komision i Integritit, t'i rrëzojmë amendimet dhe si deputete, zonja Hajdari, në bazë të Rregullores së Kuvendit mund t'ia propozojë Kuvendit amendimet, sepse hyn në gjëra teknike, specifike, kur duhet t'ia propozojë komisionit përgjegjës, jo si Komision i Integritit, por si deputete e Kuvendit të Shqipërisë.

Musa Ulqini – Kam një pyetje: a nuk mundet zonja Hajdari t'i sjellë te komisioni përgjegjës, ku jemi edhe ne, të vijë atje dhe ta dëgjojmë...? Se kështu është praktika nga pikëpamja procedurale, dikush propozon një amendim, vjen në komisionin përgjegjës, bën mbrojtjen dhe shpjegimin. Kështu është procedura.

Person f – E mbaruat komisionin ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta keni javën që vjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Po, zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Deputeti... *(nuk dëgjohet)* vetëm në komisionin ku është anëtar, jo në **(nuk dëgjohet)** por nuk mund ta paraqesim. Mund ta paraqesim vetëm në seancë plenare brenda 48 orëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person – Deri në 48 orë kohë?

Grua - Para seancës plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person – Zonja kryetare, unë rekomandoj që në fund të thuhet “në cilësinë kryetares së komisionit”. Pra, ju si deputetë jeni dakord dhe paraqitet si rekomandim në formën e raportit të komisionit.

Grua – Nuk është nevoja të marrë vendim komisioni, sepse si deputete ka të drejtën ligjore, pa aprovimin e secilit prej nesh, ta propozojë 48 orë para fillimit të seancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Person – Duhet të jetë e argumentuar...

Person – Kur planifikohet që të...?

Grua – Të enjten në datën 11. Kështu që, i bie që afat ligjor për ta depozituar ka deri të martën.

Person – Si komision nuk mund të propozohet gjë, sepse, sikurse thamë *(nuk dëgjohet)*, është kompetencë e shteteve anëtare. ... *(Nuk dëgjohet)*

Grua - Meqë ky projektligj do të shqyrtohet nga Komisioni i Edukimit, dhe ai komision drejtohet nga opozita, nuk besoj se është e nevojshme ta trajtojmë këtu nen për nen. Mund t’ia japim zonjës Dhimetri dhe ajo t’i propozojë të njëjtat propozime që kam unë me... *(nuk dëgjohet)*.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit dhe mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA